



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.1560/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Gorenje Elektromotori SHA me seli në Gjakovë, të cilin e përfaqëson kryetari i Bordit të Drejtorëve A. B., kundër të paditurit Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V. Sh., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E.nr.261/22 datës 05.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Gorenje Elektromotori SHA me seli në Gjakovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E.nr.261/22 i datës 05.07.2024, VËRTETOHET

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar K.E.nr.261/22 datës 05.07.2024, Dhoma e shkallës së parë, e ka Refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Gorenje Elektromotori SHA me seli në Gjakovë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Komuna e Gjakovës, që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të vendosjes së barrës tatimore t,ia kompensoj paditësit dëmin material në shumë prej 10,000.00€, dhe në emër të dëmtimit respektivisht shuarjes se perspektives për shkak të vendosjes së barrës tatimore t,ia kompensoj paditësit dëmin në lartësi prej 3,122,230.00€, në total në shumën në lartësi prej 3,132,230.00€,

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, me arsyetimin se nuk pajtohemi me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nga fakti se padia është bërë për shkak të dëmit shumë të madh material që ka pësuar paditësi, i propozon gjykatës që të aprovohet në tërsi ankesa e paditësit, të prishet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E..nr.261/22 datës 05.07.2024, dhe të urdhërohet gjykata të veprojnë në pajtim me ligjin për kompensimin dëmit

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi Gorenje Elektromotori SHA me seli në Gjakovë, me datë 10.07.2012, ka parashtruar padi në gjykatë, kundër të paditurit Komuna e Gjakovës, për shkak të lëshuarjes së aktvendimit për heqjen e barrës tatimore ashtu që t,ia kompensojë dëmin material në shumën prej 10,000.00€dhe në emër të dëmtimit të perspektives sipas projekteve investive ti kompensohet dëmi në shumën prej 3,122,230€, me kamatë ligjore nga data 23.03.2010, që është bërë nga vënia e barrës tatimore e deri në datën e pagesës së dëmit.

Ndër të tjera në padi dhe në seancën gjyqësore paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, thekson se mbes pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se ne vitin 2010 është informuar nfa Administrata Tatimore e Kosovës se llogaria bankare e paditësit është bllokuar, pasi që një gjë e tillë është kërkuar nga Drejtoria Kadastrale e e Komunës së Gjakovës, se me aktvendimin nr.03/1622/11-03/1596/11 datës 12.04.2012 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë, është bërë zhbllokimi i llogarisë mirëpo gjatë asaj kohe paditësi ka pretenduar se kishte qenë duke zhvilluar negociata për aktivizimin e fabrikës dhe për shkak të veprimeve jo ligjore të paditurit, paditësi ka mbetur nën bllokadën e barrës tatimore për Afro 3 vite dhe nuk ka pasur mundësi të zhvillojë asnjë aktivitet për zhvillimin e afarizmit përmes vënies së barrës tatimore pa të drejt ligjore nga i padituri, ka ndikuar që paditësi të humb projektin investiv për prodhimin e elektromotorëve trefazor nga i cili projekt fitimi tre vjeçar është parashikuar në vlerë prej 2,208,681.00€ dhe projektin investiv prodhimi i elektromotorit me kolektor nga i cili projekt fitimi 3 vjeçar është parashikuar në vlerë prej 813,549.00€. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë e paditësit si të bazuar dhe ta obligoj të paditurin që paditësit t,i kompensojë për dëmin e shkaktuar si pasojë e vënies

së barrë tatimore në vlerë të përgjithshme prej 3,432,230.00€, me kamatë ligjore nga data 25.03.2010 kur është vënë barra tatimore e deri në pagesën definitive.

I padituri në përgjigje në padi datë 17.04.2024 ka deklaruar se pretendimet e paditësit janë të njëanshme dhe të pabazuara në prova dhe pa bazë ligjore. I padituri nuk ka kompetencë që të bllokoj apo zhbllokoj llogaritë bankare të paditësit dhe rrjedhimisht një pretendim i tillë nuk është i bazuar në asnjë provë. Paditësi me asnjë provë nuk ka vërtetuar dëmin e shkaktuar si pasojë e vendimit të paditurit duke shtuar se i padituri vetëm ka trajtuar kërkesën e ATK-së, duke vepruar në bazë të dispozitave ligjore. I propozon gjykatës që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Dhoma e shkallës së parë, pas administrimit të provave në seancën gjyqësore datë 21.06.2024, ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka Refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Gorenje Elektromotori SHA me seli në Gjakovë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin, Dhoma e shkallës së parë referohet në dispozitat e nenit 154,155,158 të LMD-së, duke theksuar se kërkesëpadia e paditësit ndaj të paditurit është e pabazuar, për faktin se është vërtetuar se gjatë periudhës kur paditësit i është vënë barra tatimore nga data 25.03.2020 deri 08.03.2012 në ngastrat kadastrale nr.24/2, 24/3, 24/4, 24/5, 24/6 dhe 106/2 në sipërfaqe të përgjithshme prej 6-94-80ha sipas certifikatës UL 70705085-00016 ZK Zidi i S. A., II Gjakovë, të njëjtit nuk i është shkaktuar dëm material. Paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetoj se cili është dëmi dhe në çfarë lartësie i është shkaktuar dëm, si dhe nëse ky dëm është i lidhur me veprimin e të paditurit. Gjykata me asnjë provë nuk arriti të vërtetoj se paditësit i është bllokuar llogaria bankare nga i padituri, përveç faktit se me aktvendimin nr.267/10 dt.25.03.2020 ka vendosur barrën tatimore në pronën e paditësit, por që kjo nuk ndërlidhet në asnjë mënyrë me bllokimin e llogarive bankare të paditësit. Gjykata gjeti nëse ofertat nga kompania Candy Elektrodomestic dhe Gorenje dd, janë të vitit 2004 ndërsa periudha kur paditësit i është vendosur barra tatimore është nga data 25.03.2010 deri me datën 08.03.2012, andaj gjykata nuk gjeti ndonjë lidhje kauzale mes vendosjes se barrës tatimore dhe dëmit që ka mund ti shkaktohet paditësit.

Dhoma e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të Dhomës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e Dhomës së shkallës së parë.

Kjo gjykatë vlerëson, se Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike, për shkak se, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësi nuk ka provuar se me veprimet e të paditurit, kur i është vënë barra tatimore në periudhën kohore 25.03.2010 deri 08.03.2012, i është shkaktuar ndonjë dëm material.

Kolegji vlerësoi se dhoma e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht nenin 154, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në fuqi, që përcakton: *kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*, dhe dispozitën e nenit 155 të këtij ligji, që parasheh: *dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar) si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psikike (dëmi jomaterial)*, pra këto dispozita ligjore gjejnë mbështetje në rastin konkret pasi që gjatë procedurës gjyqësore në dhomën e shkallës së parë, paditësi nuk ka ofruar prova të argumentuara me të cilat do të vërtetohej përgjegjësia e palës së paditur për dëmin e shkaktuar ndaj paditësit me rastin e vendosjes së barrës tatimore në ngastrat kadastral dhe bllokimin e llogaris bankare.

Dhoma e shkallës së dytë, ka vlerësuar ankesën e paditësit me pretendimet se paditësi ka pësuar dëm të madh material, të shqytohët padia me provat ligjore të bashkangjitura, mirëpo këto pretendime ankimore, janë në kundërtënie me dokumentet që gjenden në shkresat e lëndës. Kolegji nga provat e lëndës nuk ka mund të provoj se cilat dokumente dëshmojnë pretendimet e paditësit për dëmin e shkaktuar nga vendosja e barrës tatimore. Gjatë seancës përgaditore dt.21.05.2024 dhe seancës kryesore datës 21.06.2024 në dhomën e shkallës së parë, në parashtresën e paditësit datë 20.06.2024, paditësi nuk ka sqaruar se cili dëm material i është shkaktuar nga veprimet e të paditurit. Provat që ka administruar dhoma e shkallës së parë, kanë të bëjnë kryesisht me kronologjin e parashtresave, ekstrakteve, akteve zyrtare, njoftimet, certifikata e paluajtshmërisë, aktet administrative, Aktgjykimi A.nr.5/2004 dt.14.12.2004 i Gjykatës Sureme të Kosovës, që ka të bëjë me tatimin e paragjykuar TM3/00 deri TM1/02 të paditësit me ATK dhe

BPR, pra nuk gjendet ndonjë provë relevante nga paditësi që ka ofruar për ti argumentuar pretendimet e tij në padi se me vendosjen e barrës tatimore i është shkaktuar dëm i madh në zhvillimin e veprimtaris afariste dhe riaktivizimit të kapaciteteve prodhuese të paditësit. Kolegji i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit, për shkak se sipas Nenit 319.1 të LPK-së, paditësi ka pasur për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e tij, ndërsa ai përkundër faktit se pretendon në dëmin e pësuar, nuk i ka ofruar gjykatës prova bindëse se e paditura ka marrë veprime të kundërligjshme me të cilat i ka shkaktuar dëm paditësit.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.1560/24 datë 12.12.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari

Krenar Berisha